


Projektbuxheti 2023

Analizë e të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore



Projektbuxheti 2023

Analizë e të hyrave dhe
shpenzimeve buxhetore

—
Dhjetor 2022

— Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	3
Projektbuxheti 2023 – pikat kryesore	4
Problemet e vazhdueshme në realizimin e buxhetit	12

Përmbledhje ekzekutive

Buxheti është instrumenti më i rëndësishëm përmes të cilit Qeveria e Kosovës mund të realizojë programin e saj, përfshirë këtu mundësinë që të zbatojë politika të reja, të mbështesë zhvillimin e sektorëve kyç për vendin, të ul pabarazinë në shoqëri, etj. Ashtu sikurse në vitet paraprake, edhe këtë vit, Instituti GAP ka analizuar ndarjet buxhetore për vitin 2023 duke i krahasuar me vitin 2022.

Projektbuxheti 2023 i përgatitur nga Qeveria shpërfaq një tendencë të rritjes më të shpejtë të shpenzimeve rrjedhëse se sa atyre kapitale, rënie të nevojës për borxh për shkak të rritjes se të hyrave buxhetore, dhe rritje të subvencioneve dhe transfereve, sidomos për shkak të pakove për përballje me inflacionin. Në këtë projektbuxhet, sektori i shëndetësisë do të ketë buxhet për rreth 38 milionë euro më shumë se sa në vitin 2022. Ndërkaq, buxheti institucioneve kryesore të arsimit do të jetë rreth 13 milionë euro më i lartë se në vitin paraprak. Krahasuar me vendet e zhvilluara, veçmas ato në Bashkimin Evropian (BE), shpenzimet si përqindje e Bruto Produktit Vendor (BPV) në këta dy sektorë të rëndësishëm mbesin ende të ulëta. Rreth tetë milionë euro më shumë se në vitin 2022 janë paraparë për sektorin e drejtësisë, ku për institucione sikurse Agjencia Kundër Korrupsion (AKK) nuk parashihet rritje që lejon forcimin e kapaciteteve të këtij institucioni, siç rekomandon dhe Raporti i Komisionit Evropian për vendin.

Projektbuxheti 2023 parasheh 65.1 milionë euro për koston shtesë në rast të aprovimit të Ligjit të pagave, 75 milionë euro për përballjen me krizën energjetike gjatë dimrit (të pranuar si grant nga BE), rreth 144 milionë euro si subvencione për Pakon e Rimëkëmbjes, etj.

Tek investimet e reja kapitale të nivelit qendror nëpër komuna vërehet një favorizim i komunave të udhëhequra nga Vetëvendosje (VV), të cilat do të përfitojnë mbi gjysmën e këtyre investimeve. Ngjashëm, Projektbuxheti 2023 parasheh edhe një ndryshim në aspektin ligjor, atë të marrjes nën menaxhim nga qeveria qendrore të mjeteve vetanake të pashpenzuara të komunave nëse të njëjtat datojnë para vitit të fundit fiskal. Kjo nismë bie ndesh me legjisllacionin në fuqi dhe ndikon negativisht në performancën e komunave.

Projektbuxheti 2023 – pikat kryesore

Rritje e theksuar e të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore dhe ulje e nevojës për borxh.

Shpenzimet buxhetore në vitin 2023 parashihet të jenë rreth 3.2 miliardë euro, që shënon një rritje prej 17% apo rreth 464 milionë euro krahasuar me vitin 2022. Ndërkaq, të hyrat buxhetore pritet të jenë rreth 2.88 miliardë euro, të cilat janë për 520.1 milionë euro (22%) më të larta krahasuar me Projektbuxhetin e vitit 2022. Këto të hyra parashihet të mbulojnë 90% të shpenzimeve buxhetore. Si rrjedhojë, nevoja për financim në vitin 2023 pritet të bie në 10% apo 326 milionë euro, nga 14% sa ishte parashikuar të ishte në vitin 2022. Niveli qendror do të ketë rreth 366 milionë (17.1%) rritje të buxhetit krahasuar me vitin 2022, ku rritje më të madhe të buxhetit pritet të kenë Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) me 189.2 milionë euro (20%) buxhet më shumë se në vitin 2022, Ministria e Mbrojtjes me rreth 21 milionë euro (20%) më shumë, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) me 20 milionë euro (123%) më shumë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve me rreth 19 milionë euro (50%) më shumë, etj. Ndërkaq, për nivelin lokal do ketë rreth 93 milionë euro (16.3%) më shumë buxhet se në vitin 2022.

Rritje më e madhe e shpenzimeve rrjedhëse se sa e atyre kapitale. Në Projektbuxhetin e vitit 2023 parashihet rritje më e shpejtë e shpenzimeve rrjedhëse se sa atyre kapitale krahasuar me vitin 2022. Konkretisht, shpenzimet rrjedhëse pritet të rriten për 18% krahasuar me vitin 2022, ndërsa ato kapitale për 15%. Ndërsa, sa i përket strukturës së shpenzimeve në bazë të peshës, në Projektbuxhetin 2023 proporcioni në mes shpenzimeve rrjedhëse dhe atyre kapitale do mbetet i njëjtë me vitin 2022, 74% dhe 26% respektivisht.

Figura 1.

Struktura e financimit të buxhetit të Kosovës





Figura 2.


Rritja e shpenzimeve kapitale dhe rrjedhëse



Rritje e theksuar e subvencioneve dhe transfereve dhe mallrave dhe shërbimeve. Tek kategoritë kryesore të shpenzimeve rrjedhëse, rritja më e madhe buxhetore reflektohet tek kategoria e subvencioneve dhe transfereve me rreth 205 milionë euro apo 23% rritje buxhetore krahasuar me vitin paraprak. Rritjen më të madhe tek kategoria e subvencioneve do ta ketë MFPT, kryesisht për shkak të një buxheti më të lartë për subvencione në kuadër të Pakos së Ringjalljes, si dhe 75 milionë eurove të buxhetuara si kontigjenca për energji. Ndërkaq, buxheti për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve është rritur për 86.1 milionë euro (23%), ku mbi 28 milionë euro nga kjo rritje janë të destinuar vetëm për Ministrinë e Mbrojtjes.

Figura 3.

Rritja e shpenzimeve rrjedhëse, 2021-2023




Mbi 65.1 milionë euro për Ligjin e pagave. Buxheti për paga dhe mëditje në vitin 2023 është rritur për rreth 75 milionë euro apo 11% krahasuar me vitin 2022. Tek kjo kategori, rreth 65.1 milionë euro janë të buxhetuara si kontigjenca për paga tek MFPT, e të cilat janë të destinuar për të mbuluar koston shtesë të një ligji të ri të pagave. Ndërkaq, pjesa tjetër prej 10 milionë euro për paga reflekton dhe rritjen e tavanit për numrin e punëtorëve, ku është krijuar hapësirë për 1,435 vende pune shtesë, nga të cilat 910 janë paraparë për nivelin qendror ndërsa 525 për nivelin komunal. Tek niveli qendror parashihen 300 vende shtesë të aprovuara për Policinë e Kosovës, 108 pozita të reja për Kuvendin e Kosovës, nga të cilat 100 si shtaf mbështetës politik, etj. Ndërkaq tek komunat, ajo e Prishtinës do të ketë rritje të numrit të lejuar të stafit për 86 punonjës, Komuna e Prizrenit për 44 punonjës, etj.

Rritje e financimit të investimeve kapitale nga buxheti i rregullt. Mbi 84% apo 681.4 milionë euro e shpenzimeve kapitale për vitin 2023 do të mbulohen nga financimi i rregullt i buxhetit dhe 16% apo 129.4 milionë euro nga klauzola e investimeve. Krahasuar me vitin 2022, financimi nga buxheti i rregullt në Projektbuxhetin 2023 parashihet të rritet për 110.4 milionë euro apo 19%. Ndërsa financimi nga klauzola e investimeve është rritur për 16.4 milionë euro apo 15% krahasuar me vitin 2022. Në vitin 2023 nuk pritet të përdoren fondet e likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), si burim financimi. As këtë vit, deri në muajin shtator, mjetet nga fondet e AKP të alokuara për vitin 2022 nuk janë shfrytëzuar fare.

Figura 4.

Financimi i shpenzimeve kapitale, në miliona euro



Rreth 200 milionë euro investime të reja kapitale. Nga gjithsej 810.7 milionë euro sa pritet të jenë investimet kapitale në vitin 2023, 611.4 milionë euro apo 75% janë planifikuar për vazhdimin e projekteve të mëhershme dhe 199.3 milionë euro apo 25% janë planifikuar për projekte të reja kapitale.

- Nga këto 611.4 milionë euro për projektet e vazhduara, rreth 89% (apo 543.3 milionë euro) janë të alokuara tek niveli qendror dhe rreth 11% (apo 68.1 milionë euro) tek komunat;
- Rreth 114.4 milionë euro apo 19% për projektet në vazhdim nga vitet e kaluara do të financohen nga klauzola e investimeve, të gjitha këto për nivelin qendror.
- Në anën tjetër, nga 199.3 milionë euro të projekteve të reja, rreth 26% (apo 51.2 milionë euro) janë të alokuara për nivelin qendror dhe pjesa tjetër prej 74% (apo 148.1 milionë euro) për nivelin lokal.
- Rreth 15 milionë euro apo 8% e projekteve të reja do të financohen nga klauzola e investimeve, nga të cilat nëntë milionë euro apo 60% janë të destinuara për nivelin qendror dhe gjashtë milionë euro apo 40% për komunat;

Investimet e reja kapitale të nivelit qendror nëpër komuna favorizojnë komunat e udhëhequra nga Vetëvendosje (VV). Për dallim nga projektet kapitale që janë vazhdimësi nga vitet paraprake, që paraqesin qasjen në buxhetim të disa qeverive me radhë, investimet e reja kapitale për këtë vit tregojnë orientimin e qeverisë aktuale në shpërndarjen e investimeve. Nga 51.2 milionë euro investime kapitale të reja të nivelit qendror këtë vit, janë rreth 22 milionë euro të cilat janë destinuar për projekte specifike në 20 komuna. Mbi gjysma e kësaj shume (52% apo 12 milionë euro) do të orientohet tek tri komunat e udhëhequra nga VV, komuna që mbulojnë 9% të territorit të Kosovës dhe 8% të popullsisë. Ndërkaq, në komunat e udhëhequra nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Partia Demokratike e Kosovës (PDK) vërehet një ndarje më e balancuar e buxhetit në raport me madhësinë e komunave dhe popullsisë.

Ndërkaq, komunat e udhëhequra nga AAK do të përfitojnë vetëm 1% të investimeve të reja kapitale nga niveli qendror përkundër se ato mbulojnë 8% të territorit të Kosovës dhe përfaqësojnë 8% të popullsisë.

Nga komunat që do të jenë përfitueset më të mëdha, veçohet Komuna e Gjilanit, e udhëhequr nga VV, e cila do të përfitojë investime me vlerë 7 milionë euro apo rreth 31% të investimeve të reja të nivelit qendror në komuna për vitin e ardhshëm. Kurse, Komuna e Shtimes, e cila po ashtu udhëheqet nga VV, do të jetë përfituesja e dytë më e madhe me rreth 3.9 milionë euro apo 17.1% të investimeve të reja. Komuna e tretë që do të përfitojë mbi 15% të investimeve kapitale të reja apo rreth 3.5 milionë euro është ajo e Mitrovicës, e udhëhequr nga PDK. Ndërkaq janë 18 komuna të cilat nuk do të përfitojnë fare nga investimet e reja të nivelit qendror në komuna.

Figura 5.

Investimet e reja kapitale krahas atyre të vazhduara




Figura 6.

Investimet e reja kapitale nga niveli qendror në komuna




Tabela 1. Investimet e reja kapitale nga niveli qendror në komuna

Komuna	Investimet e reja (€)	Investimet e reja (%)	Popullsia (%)	Sipërfaqja (%)	Subjekti Politik*	Investimet e reja për kokë banori (€)
Gjilan	7,042,500	30.7%	4.5%	3.6%	VV	95.79
Shtime	3,920,000	17.1%	1.5%	1.2%	VV	145.43
Mitrovicë	3,465,000	15.1%	3.9%	3.0%	PDK	62.01
Fushë Kosovë	1,600,000	7.0%	2.1%	0.8%	LDK	40.76
Lipjan	1,500,000	6.5%	3.2%	3.1%	LDK	554.53
Prishtinë	885,200	3.9%	11.8%	4.7%	LDK	4.04
Kamenicë	850,000	3.7%	1.7%	3.9%	VV	24.52
Istog	776,000	3.4%	2.2%	4.2%	LDK	18.87
Pejë	500,000	2.2%	5.5%	5.5%	LDK	86.06
Prizren	457,500	2.0%	10.7%	5.5%	PDK	2.36
Skenderaj	430,000	1.9%	2.9%	3.4%	PDK	8.18
Drenas	380,000	1.7%	3.4%	2.5%	PDK	6.26
Malishevë	250,000	1.1%	3.2%	2.8%	NISMA	4.35
Dragash	200,000	0.9%	1.9%	3.9%	LDK	5.97
Ferizaj	200,000	0.9%	5.7%	3.2%	PDK	1.89
Klllokot	180,000	0.8%	0.2%	0.2%	LS	4.48
Klinë	100,000	0.4%	2.2%	2.8%	AAK	3.82
Shtërpcë	100,000	0.4%	0.4%	2.3%	LS	15.38
Kaçanik	60,000	0.3%	1.9%	1.9%	PDK	9.44
Gjakovë	20,000	0.1%	5.3%	5.4%	AAK	0.22


* Subjekti politik i cili udhëheq me postin e kryetarit/es të komunës

75 milionë euro për përballjen me krizën energjetike. Në Projektbuxhetin 2023 janë buxhetuar 75 milionë euro si kontigjenca për përballjen me krizën potenciale të energjisë, të cilat janë përfituar si grant nga Bashkimi Evropian.

Rreth 38 milionë euro më shumë për shëndetësi se në vitin 2022. Për institucionet që mbulojnë fushën e shëndetësisë, përfshirë Ministrinë e Shëndetësisë, Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar, komunat, dhe Fondin e Sigurimeve Shëndetësore, për vitin 2023 është ndarë buxhet prej 296.2 milionë euro apo 38 milionë euro (15%) më shumë se në vitin 2022. Buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë është rritur për 26% apo 15.7 milionë euro ku rreth gjysma parashihen për investime kapitale, ndërsaq buxheti i Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar është rritur për 12.3 milionë euro apo 10%, ku rreth 80% e kësaj rritjeje pritet të shkojë në mallra dhe shërbime. Kurse, granti për shëndetësi në komuna është rritur për 7.9 milionë euro apo 13%, ndërsa Fondi i Sigurimeve shëndetësore është rritur për 2 milionë euro apo 30%.

Figura 7.


Buxheti për shëndetësi, 2021-2023



Krahasuar me shtetet e zhvilluara dhe ato në rajon, shpenzimet në sektorin e shëndetësisë në Kosovë mbesin të ulëta edhe në vitin 2023, me rreth 3% të Bruto Produktit Vendor. Sipas të dhënave të Eurostat, mesatarja e BE-së për shpenzimet publike në shëndetësi është 7.9%, në Bosnje dhe Hercegovinë 6.4%, në Serbi 5.1%, në Turqi 3.9%, në Shqipëri (3.2%).¹

Figura 8.

Shpenzimet në shëndetësi (% e BPV-së 2020)




Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Eurostat, ASK dhe MFPT

Rreth 39 milionë euro më shumë për pensione dhe politika sociale dhe 144 milionë euro subvencione dhe transfere për Pakon e Rimëkëmbjes. Pensionet dhe kompensimet parashihet të rriten për 21,3 milionë euro apo 6%, pensionet për kategorinë e luftës për 3.7 milionë euro apo 3%, politikat dhe shërbimet sociale për 13.6 milionë euro apo 13%, shpenzimet për skemën e ndihmës sociale për rreth 3 milionë euro apo 6.8%, ndërkaq pensionet për veteranë kanë mbetur të pandryshuara. Mirëpo, në kuadër të MFTP-së janë ndarë edhe 144 milionë euro në formë të subvencioneve dhe transfereve, nga të cilat deri më tani kanë përfituar shumë nga kategoritë pensionale dhe familjet në skemë sociale.

Figura 9.

Buxheti i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT)




Rritje e theksuar e buxhetit për rezervat ushqimore dhe përkrahjen e ndërmarrjeve në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (MTI). Në vitin 2023, planifikohet një shumëfishim i buxhetit të Departamentit të rezervave në MTI, ku buxheti total do të jetë 15.3 milionë euro, dhe i cili do të destinohet për rritjen e rezervave ushqimore bazike, veçmas për shkak të situatës së rënduar me çmime në tregje. Ngjashëm, rritje prej rreth 4.7 milionë euro apo 47% do të ketë për departamentin që përkrah inovacionin dhe ndërmarrësinë.

¹ Eurostat. Burimi: <https://bit.ly/3u4sqpw>

Rreth 13 milionë euro më shumë për institucionet kryesore në sektorin e arsimit. Në Projektbuxhetin 2023 parashihet një rritje prej 12.9 milionë euro apo 4.2% krahasuar me vitin 2022. Nga kjo rritje do të përfitojnë kryesisht Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë me rreth 10.7 milionë euro buxhet shtesë dhe komunat përmes grantit për arsim me rreth 1.4 milionë euro shtesë.

Figura 10.


Buxheti për arsim, 2022–2023



Mirëpo, krahasuar me vendet e BE-së, Kosova ende shpenzon ndjeshëm më pak në arsim. Në mesatare, vendet e BE-së në vitin 2020 shpenzonin 5% të BPV-së në arsim², ndërsa me Projektbuxhetin e vitit 2023 shpenzimet në arsim në Kosovë do të jenë rreth 4.3% të BPV-së. Kur krahasojmë nivelin e ulët të BPV-së në Kosovë, moshën e re të popullisë dhe rezultatet e testit PISA, atëherë del Kosova do të duhej t'i rriste dukshëm shpenzimet në arsim.

Figura 11.

Shpenzimet në arsim (% e BPV-së 2020)




Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Eurostat, ASK dhe MFPT

Tetë milionë euro më shumë për sektorin e drejtësisë. Sipas Projektbuxhetit 2023, buxheti për pesë institucionet qendrore, Prokurori i Shtetit/Këshilli Prokurorial i Kosovës (PSH/KPK), Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), Instituti Gjyqësor i Kosovës/ Akademia e Drejtësisë (IGJK/AD), Ministria e Drejtësisë (MD), Agjencia për Ndihmë Juridike Falas (ANJF) dhe Agjensioni Kundër-Korrupsion (AKK) parashihet të jetë rreth 88 milionë euro. Krahasuar me vitin 2022, rritjen më të lartë të buxhetit do ta ketë Ministria e Drejtësisë me 6.8 milionë euro apo 23% dhe KGJK për rreth dy milionë euro apo 6%. Ngjashëm edhe buxheti për IGJK-në do të jetë për 232 mijë euro apo 35% më i lartë, për ANJF-në 175 mijë euro më i lartë (0.04%), dhe për AKK-në 12 mijë euro apo 2% më i lartë. Përkundër se Komisioni Evropian në raportin për vendin ka rekomanduar që të rriten kapacitetet dhe numri i stafit i AKK³, në mënyrë që ky institucion ta zbatojë efektivisht mandatin e tij, për vitin 2023 nuk është paraparë buxhet i mjaftueshëm as për mbulimin e ndonjë vendi shtesë të punës. Ndërkaq, buxheti i KPK-së për vitin 2023 pritet të jetë për 1.2 milion euro apo 7% më i ulët, ku ulja e buxhetit është kryesisht në kategorinë e shpenzimeve kapitale.

Figura 12.

Buxheti për disa institucione të sundimit të ligjit




Rishpërndarja e të hyrave vetanake të komunave të shpenzuara nga vitet e mëhershme. Në Projektbuxhetin 2023, neni 9.6, kërkon që të gjitha të hyrat vetanake të komunave të mbledhura para vitit 2022 dhe që janë të pashpenzuara, të barten e të merren nën menaxhim dhe të përdoren nga Qeveria për nevoja të ndryshme. Në vitin 2021, mjete të bartura nga vitet e mëhershme ishin 55.4 milionë euro, ndërkaq në vitin 2020 mjete të bartura nga viti 2019 dhe më herët ishin rreth 49.5 milionë euro. Një nismë e tillë do të mund të ndikonte ndjeshëm të hyrat e komunave, konkretisht projektet të cilat veçse mund të kenë filluar, për të cilat financimi mund të jetë bazuar në këto të hyra. Për shembull, në vitin 2021 ishin shpenzuar mbi 58% e këtyre mjeteve të bartura nga viti 2019 ose më herët. Në anën tjetër, është e rëndësishme që komunat të rrisin efektivitetin në shpenzimin e parasë publike për shkak të kostove oportune të mos shpenzimit të parasë. Në vitin 2022, mos-funksionalizimi i Organit Shqyrtues të Prokurimit për një kohë të gjatë si dhe rritja e çmimeve të produkteve të ndërtimit kanë ndikuar po ashtu negativisht në normën e realizimit të investimeve kapitale nga komunat, ndonëse të dhënat rreth realizimit të investimeve kapitale dallojnë thelbësisht nga komuna në komunë. Deri në shtator të këtij viti, në disa komuna kishte performancë tepër të ulët në realizimin e investimeve kapitale, ndërkaq në disa tjera një dinamikë tejet të shtuar. Nga komunat me më shumë buxhet nën menaxhim për investime kapitale, performancë më të ulët kishin ajo e Prishtinës më vetëm 9% realizim të investimeve kapitale, Vushtrria me 13%, Fushë Kosova me 4%, etj. Ndërkaq, nga komunat të cilat menaxhojnë po ashtu me më shumë buxhet por kanë treguar nivel më të lartë të ekzekutimit të projekteve janë ajo e Ferizajt me 70%, Gjilanit me 61%, Pejës me 36%, etj.

3 Komisioni Evropian. Raporti për vendin 2022. Burimi: <https://bit.ly/3GLwiyO>

Figura 13.

Realizimi i investimeve kapitale nga komunat, janar-shtator 2022




Problemet e vazhdueshme në realizimin e buxhetit

Dinamikë e ulët e realizimit të investimeve kapitale.

Ndonëse investimet kapitale zënë një pjesë të konsiderueshme të buxhetit vjetor dhe paraqesin kategorinë kryesore përmes të cilës qeveria mund të bëjë ndryshime në ekonomi, planifikimi dhe niveli i realizimit të kësaj kategorie mbetet jo i kënaqshëm. Janë një sërë faktorësh që kanë ndikuar në këtë situatë, përfshirë pandeminë COVID-19, hyrjen në realizim të projekteve të mëdha infrastrukturore me donatorë të mëdhenjë pa pasur njësi implementuese me kapacitete të mjaftueshme, mos funksionaliteti i Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik për një kohë të gjatë, etj. Mirëpo, element kyç mbetet planifikimi jo i duhur, ku nuk analizohen mirë shkaqet që mund të ndikojnë në mos realizim të projekteve. Ngjashëm, gjatë vitit 2022 ndikim në këtë kishte edhe reagimi i vonshëm i Qeverisë për të përshtatur rritjen e kostos së ndërtimit në kontratat e projekteve kapitale, ku një ligj që e trajton këtë pjesë u miratua vetëm në nëntor të vitit 2022, ndonëse rritja e çmimeve dhe indikacionet për probleme me inflacionin ekzistojnë që nga fundviti 2021. Pasojat për mos shpenzim të tillë të mjeteve janë të shumfishta, nisur nga kosto oportune, ku mjetet e pashpenzuara e alokuara për ndërtimin e një rruge do të mund të alokoheshin për projekte të tjera.

Figura 14.

Trendi i realizimit të investimeve kapitale në Kosovë, 2016–2021



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Thesarit (MFPT)

Mos ndërlidhje e buxhetit me dokumentet strategjike afatmesme dhe afatgjata. Në të kaluarën është vërejtur një ndërlidhje e vogël mes buxhetimit vjetor dhe dokumenteve strategjike zhvillimore, sikurse Strategjia Kombëtare për Zhvillim (SKZH) 2016–2021 apo Programi për Reforma në Ekonomi. Kjo ka rezultuar me mos përmbushje të targeteve të vëna në SKZH 2016–2021. Ndonëse nga viti 2020 kriza e shëndetit publik, si pasojë e pandemisë, dhe kriza me inflacionin kanë imponuar një shmangie nga ndryshimet strukturore, është adekuate që të ketë vendosje të prioriteve të vëna në ligjin vjetor të buxhetit me këto dokumente. Mungesa e një strategjie zhvillimore afatgjate pamundëson reforma të mëdha dhe rrenjësore në vend, meqë të njëjtat marrin kohë të gjatë për t'u ideuar, planifikuar dhe vënë në zbatim. Ngjashëm, Ligji i buxhetit duhet të ndjekë në masë të theksuar trasenë e vënë tek Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH), në mënyrë që të ketë një qëndrueshmëri fiskale.

Përdorim i madh i linjave buxhetore pa destimin. Viteve të fundit, vërehet një tendencë e përdorimit të një numri linjash buxhetore të cilat nuk përmbajnë projekte specifike, por janë përfshirë në kuadër të disa aktiviteteve të përgjithshme. Në Projektbuxhetin 2023 do të ketë kontigjenca për investime kapitale që do të jenë mbi 20 milionë euro, kontigjenca për subvencione mbi 40 milionë euro, etj. Këto janë bërë krahas kontigjencave të tjera, sikurse ajo për energji me mbi 75 milionë euro apo ajo për mbulimin e pagave sipas ndryshimeve përmes Ligjit të ri të pagave me mbi 65.1 milionë euro, destinimi i të cilave është më i përcaktuar. Praktikrat e mira të buxhetimit kërkojnë planifikim adekuat në mënyrë që shpenzimi i parasë publike të jetë efektiv.

Po ashtu, në Projektbuxhetin e vitit 2023, ende vijojnë të përfshihen linja të përgjithshme, ku nuk dihet destinimi i saktë i mjeteve. Në projektbuxhetin 2023 ka linja sikurse ajo tek komuna e Klinës "Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktures nentokesore në Klinë", tek komuna e Istogut "Ndërtimi i rrugëve në Istog", tek MKRS "Renovimi i poligoneve sportive shkollore" apo "Ndërtimi i Fushave të Tenisit në Komuna të Ndryshme" etj., në të cilat nuk specifikohet lokacioni i investimeve. Kjo praktikë i jep një diskrecion të madh kryetarit/es të komunës apo ministrit/es dhe nuk siguron shpenzim efektiv të parasë publike. Veçmas që projektet të cilat financohen janë të zgjedhura ad-hoc dhe mund të orinetohen në baza partiake. Po ashtu, një praktikë e tillë është në kundërshtim me Udhëzimi Administrativ për kriteret përzgjedhëse dhe prioritizimin e projekteve kapitale të MFPT, i cili e sqaron qartazi se në ligjet e buxhetit duhet të përfshihen vetëm ato projekte kapitale ku tregohet rëndësia strategjike e tyre, ndikimi ekonomik dhe ekzistimi i planit të realizimit.⁴

Neglizhimi i perspektivës gjinore në projektbuxhet. Përkundër që legjislati në fuqi në Kosovë kërkon përfshirjen e perspektivës gjinore në buxhetim, si dhe ofron manuale se si të bëhet vlerësimi gjinor i politikave të ndryshme, dokumentet strategjike, sikurse Projektbuxheti 2023, nuk përfshijnë vlerësim gjinor të buxhetit. Përfshi këtu një vlerësim gjinor të buxhetit apo një analizë që tregon se si ndikohen gratë dhe burrat nga ndërtimi i infrastrukturës rrugore, ndërtimi i çerdheve, ndërtimi i stadioneve, ndriçimi i trotuarëve, etj. Pikërisht tek pjesa e investimeve kapitale, të dhënat tregojnë se për disa nga projektet me peshën më të madhe në buxhet, projektet e përzgjedhura nuk kanë ngëthyer edhe vlerësime të ndikimit gjinor.⁵ Ngjashëm nuk përfshihet ndonjë analizë se si ndihkohen burrat dhe gratë nga kategoria e pagave në Projektbuxhet, marrë parasysh se raporti i punësimit në shërbimin civil në nivelin qendror dhe në administratën komunale është 67% burra dhe 33% gra, apo nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve, ku 66% e pranuesve të ndihmës sociale në Kosovë janë burra, etj.⁶ Po ashtu, Projektbuxheti do duhej të përmbante analizë se si mëton të përmirësojë barazinë gjinore në vend marrë parasysh normën e lartë të papunësisë së grave (23.9%) dhe shkallës së jo-aktivitetit të tyre (77.5%).⁷

4 Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.


Burimi: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/C67DFC33-2744-4957-8D3E-83ACA5614DD3.pdf>

5 Public Expenditure and Financial Accountability (PEFA) performance assessment report. Burimi: <https://bit.ly/3F5mLNI>

6 Instituti GAP. Punësimi dhe përfaqësimi i grave në Kosovë 2019. Burimi: <https://bit.ly/3H8ZYCn>

7 Agjencia e Statistikave të Kosovës. Tregu i punës, TM3 2021. Burimi: <https://bit.ly/3AZMJjr>

Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.



Instituti GAP përkrahët nga:

